



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P - 59
Prishtinë, më 3 maj 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 3 MAJ 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare, ndërsa për fjalë u paraqit ministri Fehmi Mujota.

Fehmi Mujota, në emër të Qeverisë së Kosovës, kërkoi që Kuvendi ta miratojë propozimin për heqjen nga rendi i ditës të mbledhjes së sotme plenare të pikës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror. Ai tha se kjo pikë mund të radhitet për shqyrtim në mbledhjen e radhës, por pas konsultimeve, që do të bëhen me Këshillin e NATO-s.

Kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal të deklarohen për propozimin e lartpërmendur.

Kuvendi e miratoi propozimin për heqjen nga rendi i ditës të mbledhjes së sotme plenare të pikës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Debat parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë,
9. Shqyrtimi i Vendimit të Presidencës së Kosovës për kthimin në shqyrtim të Ligjit nr. 04/L- 084, për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Emilija Rexhepi, Haki Demolli, Alma Lama, Ganimete Musliu, Sabri Hamiti, Sevdie Lama, Ardian Gjini, Berat Buzhala, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Blerta Deliu-Kodra deklaroi se për pyetjen e parashtruar për ministrin Ferid Agani e ka marrë përgjigjen me shkrim.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtrroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me lejimin e aktiviteteve të strukturave ilegale në organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, dhe me çfarë baze ligjore dhe kushtetuese jeni mbështetur, kur ka deklaruar se do ta lehtësojë pjesëmarrjen në votim në organizimin e zgjedhjeve të shtetit armik serb. Kryeministri nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtrroi pyetje për ministren Vlora Çitaku në lidhje me rezultatin e vizitës në SHBA, nëse ajo i përket procesit të integrimeve evropiane. Ministrja Vlora Çitaku iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtrroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me udhëzimin administrativ nr. 13/2011 të Ministrisë që ai drejton, për avancimin profesional pa shkëputje nga puna për mësimdhënësit dhe edukatorët, të cilët ushtrojnë veprimtari edukative dhe arsimore më shumë se tre vjet.

Ministri Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputeti Lutfi Haziri parashtoi pyetje për zv.kryeministrin Slllobodan Petroviq në lidhje me ndërhyrjet e Ministrisë që ai drejton në vendosjen e ligjit në të gjitha rastet në komunat e Kosovës për vitin 2011 dhe për këtë vit.

Zv.kryeministri Slllobodan Petroviq iu përgjigj pyetjes së deputetit Lutfi Haziri.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria që ai drejton për ta zgjidhur çështjen e hyrjes së shtetasve turq në territorin e Kosovës.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Nazane Breca parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për specializim në mjekësinë familjare, e cila bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, e jo nga komunat.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Nazane Breca parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me veprimet që ka ndërmarrë Ministria që ai drejton për zbatimin e kontratës me mjekët që e kryejnë specializimin, për t'u kthyer në vendet e tyre të punës.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputeti Burim Ramadani parashtoi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë se cilave shtete të BE-së, Ministria që ai drejton i ka bërë kërkesë për trajnimet e njësitit të pilotëve të helikopterëve në Policinë e Kosovës.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Burim Ramadani.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 18, 19 dhe 20 prill 2012

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare të datës 18, 19 dhe 20 prill 2012.

4. Debat parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, e ftoi kryetaren e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për prezantimin dhe arsyetimin e Raportit me rekomandime.

Suzana Novobërdaliu fillimisht tha se përderisa të mos gjendet personi i fundit i zhdukur nga lufta në Kosovë, kërkimi për ta, por edhe ankthi për familjarët e tyre, dhe për të gjithë ne, do të vazhdojë. Zhdukja e njerëzve është një prej krimeve më të rënda kundër njerëzimit, ndërsa zbardhja e fatit të të pagjeturve nga lufta në Kosovë është përgjegjësi e autoriteteve ndërkombëtare dhe e institucioneve të Kosovë, konstatoi ajo.

Në vazhdim, deputetja Suzana Novobërdaliu theksoi se me gjithë faktin që dihen rrethanat e vrasjeve të mbi 13 000 personave gjatë luftës në Kosovë, Gjyqësori në Kosovë deri më tani ka ngrehur vetëm 10 raste.

Ajo më tej theksoi se ka dyshime se disa nga të zhdukurit janë djegur nëpër furnalta, gjë që e bënë akoma më të vështirë zbardhjen e këtyre rasteve.

Serbia duhet të përgjigjet sipas së drejtës ndërkombëtare për krimet e shkaktuara në Kosovë.

Më pas ajo theksoi se historia nuk ka shënuar asnjë rast, në asnjë vend të botës, që të zhdukurit, pas përfundimit të luftërave, të mos këmbehen.

Në vazhdim ajo u fokusua edhe në vënien e gurthemelit të memorialit për personat e zhdukur, gjë që u bë më 27 prill 2012, në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve.

Në fund, deputetja paraqiti para Kuvendit 5 rekomandime, për të cilat tha se mund të riformulohen, varësisht nga rrjedha e debatit.

Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se kjo çështje është një ndër problemet më të mëdha që nga koha e luftës, e cila për 13 vjet vazhdon t'i mbajë në ankth familjarët e të pagjeturve.

Në vazhdim, ajo theksoi se përgjegjës për vrasjet dhe zhdukjen e personave të pagjetur janë ata që planifikuan, ekzekutuan dhe ata që sot po i fshehin krimet e shkaktuara nga shteti serb. Më tutje ajo e theksoi nevojën e rritjes së presionit mbi Beogradin zyrtar nga institucionet ndërkombëtare dhe EULEX-i për zbardhjen sa më parë të fatit të të zhdukurve.

Ajo më pas u fokusua në mundësinë e hapjes sa më parë të 36 lokacioneve, ku dyshohet se ka varrezë masive me të zhdukur dhe të 29 lokacioneve të tjera, për të cilat po ashtu ka dyshime për varreza masive.

Në fund, deputetja Blerta Deliu-Kodra kërkoi që çështja e të zhdukurve nga lufta në Kosovë të jetë pikë e dialogut Kosovë-Serbi, i cili po zhvillohet në Bruksel.

Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, çështjen e të zhdukurve nga lufta në Kosovë e vlerësoi si gjenocid të shtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Në vazhdim, ajo u fokusua në infrastrukturën ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës lidhur me çështjen e të zhdukurve, për ç'gjë tha se nuk po zbatohet sa duhet.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj e shtroi nevojën imediate të rritjes së presionit nga EULEX-i, BE-së dhe Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, ndaj autoriteteve shtetërore në Serbi, për zbardhjen e fatit të të zhdukurve në Kosovë.

Në fund, ajo propozoi që rekomandimeve nga ky debat t'u shtohet edhe një pikë, e cila ka të bëjë me faktin që çështja e të zhdukurve nga lufta në Kosovë të jetë çështje prioritare në bisedimet Kosovë-Serbi, të cilat po zhvillohet në Bruksel.

Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fillimisht tha se për familjet e të pagjeturve lufta ende nuk ka përfunduar.

Në vazhdim, ai theksoi se familjet e të pagjeturve nuk e kanë pasur asnjëherë përkrahjen e Qeverisë për zgjidhjen njëherë e përgjithmonë të kësaj çështjeje, ndërsa tha se Beogradi zyrtar e ka përdorur çështjen e të pagjeturve në Kosovë përherë për poenë politike.

Më pas, ai tha se çështja e të zhdukurve të luftës në Kosovë nuk është përfshirë as në Marrëveshjen e Kumanovës, në atë mënyrë që Serbia vazhdimisht u mundua ta fshehtë të vërtetën, duke i varrosur kufomat e shqiptarëve në liqenet dhe lumenjtë e vet, gjë të cilën e ilustroi me numrin prej 860 kufomave, që u gjetën vetëm në Batajnicë.

Deputeti Kurti në vazhdim e përmendi edhe rastin e zhdukjes së atdhetarit Ukshin Hoti, duke e vlerësuar jo të mjaftueshëm angazhimin e institucioneve të Kosovës për zbardhjen e fatit të tij dhe të të gjithë të zhdukurve të tjerë.

Serbia duhet t'i hapë dosjet për të zhdukurit në Kosovë, ajo i ka ato, ndërkaq shtoi se shteti serb i ka treguar dosjet e vrasjeve në Vukovar të Kroacisë.

Më tej, ai e shtroi nevojën e një hetuesie të pavarur për zhvillimin e procedurave legale për ndjekjen e kriminelëve, të cilët shkaktuan krime në Kosovë.

Kimete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se shteti serb në lidhje me çështjen e të zhdukurve në Kosovë duhet të sillet konform Konventës së Gjenevës të vitit 1979.

Në vazhdim, ajo u fokusua në aktivitetet e pamjaftueshme të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, dhe në moszbatimin e rezolutës së Kuvendit të Kosovës, e cila i referohet kësaj problematike, e miratuar në vitin 2005.

Deputetja Bajraktari, në lidhje me çështjen e të zhdukurve nga lufta në Kosovë, si temë e bisedimeve Kosovë-Serbi, të cilat po mbahen në Bruksel, konstatoi se zv.kryeministria Edita Tahiri, si udhëheqëse e këtyre bisedimeve nga pala kosovare, duhet ta tregojë rezultatin dhe epilogun e tyre.

Në fund, ajo e shtroi çështjen e moskonstituimit të Gjykatës Speciale për Krimet e Luftës në Kosovë.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se edhe grupi që ajo e përfaqëson vlerëson se është momenti i fundit që institucionet e Republikës së Kosovës ta vendosin çështjen e të zhdukurve si prioritet në bisedimet Kosovë-Serbi, të cilat po mbahen në Bruksel.

Në vazhdim, ajo e shtroi nevojën që institucionet vendore ta ndërmarrin një fushatë të gjerë për sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar, në mënyrë që ky i fundit ta shtojë presionin mbi palën serbe për zbardhjen e fatit të të zhdukurve nga lufta në Kosovë.

Sasha Milosavleviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, u fokusua në rekomandimet e paraqitura për këtë pikë nga kryetarja e Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Ai në vazhdim tha se anëtarja e këtij komisioni nga Grupit Parlamentar SLS nuk ka marrë pjesë në përpilimin e këtyre rekomandimeve.

Ai më pas theksoi se grupi që ai përfaqëson nuk i përkrah rekomandimet e paraqitura nga kryetarja e Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, tha se çështjen e të zhdukurve nga lufta në Kosovë e vlerësojnë si çështje të ndjeshme dhe të rëndësishme.

Në vazhdim theksoi se pas 13 vjetësh nga lufta në Kosovë, shumica e familjarëve po e humbin besimin për ndriçimin e fatit të të zhdukurve.

Ndërsa angazhimin e Qeverisë dhe të institucione ndërkombëtare për zbardhjen e fatit të të zhdukurve, ai e vlerësoi jo të mjaftueshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Kurtan Kajtazi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Kimete Bytyqi, Ganimete Musliu, Teuta Haxhiu, Afrim Hoti, Goran Marinkoviq, Flora Brovina, Teuta Sahatçija, Albana Gashi, Biserka Kostiq, Halit Krasniqi, Vjosa Osmani, Hydajet Hyseni, Sali Asllanaj, Vesna Mikiq, Sevdie Lama, Arsim Bajrami, Imri Ahmeti, Ardian Gjini, Nait Hasani, Jasmina Zhivkoviq, Xhevahire Izmaqu, Bekim Haxhiu, Agim Kuleta, Sabri Hamiti dhe Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetja Flora Brovina tha se diskutimin në tërësi do ta dorëzojë me shkrim.

Suzana Novobërdaliu, në emër të Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në fund të debatit e përkrahu propozimin e deputetit Sabri Hamiti, që të riformulohen rekomandimet dhe të njëjtat të hidhen në votim në mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari në vazhdim kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal të deklarohen lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Kuvendi e miratoi propozimin për riformulimin e rekomandimeve lidhur me fatin e të zhdukurve nga lufta në Kosovë, e pastaj ato rekomandime të procedohen për votim në mbledhjen plenare të radhës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale.

Raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Safete Hadërgjonaj.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, dhe 3.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 7,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Safete Hadërgjonaj.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3 dhe amendamentin nr. 4.

Kryetari pastaj e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 8,

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Safete Hadërgjonaj.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11- i plotësuar sipas diskutimit të deputetes Safete Hadërgjonaj, dhe amendamentin nr. 12.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 55,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë.

Raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, znj.Safete Hadërgjonaj.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe amendamentin nr. 12.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë.

9. Shqyrtimi i Vendimit të Presidencës së Kosovës për kthimin në shqyrtim të Ligjit nr. 04/L-084, për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar vendimin e Presidentes së Kosovës për kthim në Kuvend të ligjit nr. 04/L-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Ahmet Isufi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Rexhep Selimi, Vjollca Krasniqi, Fatmir Xhelili, Emin Gërbeshi, Sabri Hamiti, Daut Haradinaj dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Presidentja.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin e propozuar nga Presidentja.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi nuk e miratoi amendamentin e propozuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L – 84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.
2. Ligji nr. 04/L - 84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës mbetet ashtu siç është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 15 mars 2012, dhe konsiderohet i shpallur.
3. Ligji nr. 04/L - 84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës procedohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës për publikim.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 16:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale